



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.82

8 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.487, datë 6.5.2009	Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, të pronarëve, në të holla, për vitin 2009	3607
Vendim i KM nr.498, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr. 438 , datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, të ndryshuar	3613
Vendim i KM nr.526, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e atashëve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndërkombëtare”, të ndryshuar	3614
Vendim i KM nr.527, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1315, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës “SECI”	3615
Vendim i KM nr.528, datë 27.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.932, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve shqiptarë, për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme, homologe të shteteve të ndryshme, të atashuara në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar	3616

Vendim i KM nr.529, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja”, të ndryshuar	3617
Vendim i KM nr.530, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr. 638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar	3619
Vendim i KM nr.533, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.1092, datë 2.07.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të doganave”	3627
Vendim i KM nr.581, datë 28.5.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të 28 qershorit të vitit 2009	3628
Vendim i KM nr.582, datë 27.4.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	3629
Vendim i GJL nr.2, datë 6.1.2009	Me objekt ndryshimin e vendimit nr.290, datë 10.12.2007 të ZRKK Pronave qarku Korçë, pika a.1 për sipërfaqen prej 10 000 m ² , ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të ish-KKKP bashkia Korçë, detyrimin për njohjen dhe kthimin e sipërfaqes prej 10 000 m ²	3638
Udhëzim i KQZ nr.16, datë 8.5.2009	Për përcaktimin e rregullave për shpërndarjen dhe rishpërndarjen e fondeve publike për subjektet zgjedhore	3645
Udhëzim i KQZ nr.17, datë 22.5.2009	Për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për procesin e numërimit të votave për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, 2009	3646
Vendim i ERE nr.34, datë 7.5.2009	Për licencimin e shoqërisë “Wonder Power” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	3648
Vendim i ERE nr.35, datë 7.5.2009	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	3649
Vendim i ERE nr.36, datë 7.5.2009	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	3649
Vendim i KNSH nr.31, datë 6.5.2009	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për shpalljen e zonës ekonomike me statusin e zonës së lirë, Vlorë”	3650

VENDIM
Nr.487, datë 6.5.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË KRITEREVE PËR SHPËRNDARJEN E
FONDIT TË KOMPENSIMIT, TË PRONARËVE, NË TË HOLLA, PËR VITIN 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, shkronja “d”, pika 1 e 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është njohur e gjitha për kompensim, të kompensohen sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri dhe data e vendimit, vetëm nëse nuk kanë përfituar:

- a) nga kompensimet e mëparshme;
- b) kthim fizik të pjesshëm të pronës, me çdo vendim për atë subjekt;
- c) nga e drejta e parablerjes;
- ç) nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

Në rastin e vendimeve, të cilat janë ndryshuar pjesërisht, për efekt klasifikimi do të merret numri dhe data e vendimit bazë, që është më i hershëm në radhë kronologjike për njohjen, kthimin dhe kompensimin e asaj prone.

2. Kompensimi të bëhet vetëm për deri 200 (dyqind) m² të sipërfaqes truall, të caktuar për kompensim, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës së miratuar, sipas vendndodhjes së pronës, që kompensohet.

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2006, 2007, 2008 dhe që vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit për vitin 2009.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë, pranë zyrës së AKKP-së në qendër, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për kompensim në të holla, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- b) Deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, dhe të kushteve të tjera, që lidhen me kriteret, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- c) Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për njohjen dhe kompensimin e pronës, së bashku me planvendosjen përkatëse, të njehsuara nga institucioni, ku ato janë të arkivuara.
- ç) Dëshminë e trashëgimisë;
- d) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të subjektit të shpronësuar;
- dh) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (letërnjoftim apo pasaportë) të përfaqësuesit të pajisur me prokurë;
- e) Dokumentin, që vërteton vendbanimin, më 19.7.1991, të subjektit të shpronësuar;
- ë) Mandatpagesën.

5. Në rastin e kërkesave të paraqitura pranë AKKP-së, në mbështetje të vendimit nr.1343, datë 4.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2008”, dhe për të cilat AKKP-ja nuk ka dhënë ende vendim, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kërkuesit duhet të pohojnë vullnetin e tyre, nëpërmjet një kërkesë të re, për kompensimin, të shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi.

6. Subjektet, që kanë aplikuar për kompensimin në të holla, në vitin 2008, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për kompensim financiar, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, dhe të kushteve të tjera, që lidhen me kriteret, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Dëshminë e trashëgimisë, kur në dëshminë e paraqitur në vitin 2008 ka ndryshime të trashëgimtarëve të ligjshëm të subjektit të shpronësuar, sipas radhës së trashëgimtarëve, të përcaktuar në Kodin Civil;

ç) Prokurën e posaçme, nëse ajo e paraqitur në vitin 2008, ka kufizimin në kohë për tagrin e tërheqjes së shumës në të holla apo kur rrethi i trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar ka ndryshuar;

d) Dokumentin, që vërteton vendbanimin më datë 19.7.1991, të subjektit të shpronësuar, për personat, që nuk kanë vërtetimet e SAMT-ve në dosje.

7. Zyra e AKKP-së në qendër, në bashkëpunim me zyrat rajonale, shqyrton dokumentacionin e subjekteve, që kërkojnë kompensim në të holla.

8. Zyra rajonale e kthimit dhe kompensimit të pronave kryen veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe vendimet e tjera për këtë subjekt të shpronësuar.

b) Kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që, brenda 10 ditëve, të konfirmojnë, duke plotësuar rubrikat në modelarin tip 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

i) vlefshmërinë e regjistrimit të vendimit përkatës në ZVRPP;

ii) verifikimin e ndryshimit të gjendjes juridike të pronës nga çasti i daljes së vendimit të paraqitur nga subjekti përkatës;

iii) verifikimin e regjistrimit dhe të ushtrimit të së drejtës së parablerjes;

iv) verifikimin, nëse subjekti i shpronësuar ka të regjistruar pronë të përfituar me kthim nga vendime të tjera të ish-KKKP-ve apo ish-KVKKP-ve, pranë ish-këshillave të rretheve e bashkive apo të ZRKKP-ve në qarqe, në emër të tij.

c) Kërkon nga SAMT-ja e qarkut përkatës verifikimin nëse subjekti i shpronësuar ka përfituar tokë bujqësore, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar.

Në ato raste kur vendbanimet e subjektit të shpronësuar apo të trashëgimtarëve të tij, më 19.7.1991 kanë qenë në rrethe apo qarqe të ndryshme, konfirmimet do të merren nga SAMT-të e qarqeve, ku kanë banuar. Këto verifikime pranë SAMT-ve kryhen pa kundërshtim.

ç) Verifikon në arkivën e të dhënave të gjitha vendimet për këtë subjekt, për identifikimin e vendimeve për kthim dhe kompensim të pronave të tij.

d) Kryen verifikimin në terren të gjendjes së pronës dhe mban procesverbalin përkatës.

dh) Përgatit planvendosjen e pronës dhe cakton:

i) në hartën e vlerës, zonën, ku ndodhet prona;

ii) në bashkëpunim me subjektin e shpronësuar, pjesën e pronës, që kërkohet për t'u kompensuar, kur prona është mbi 200 (dyqind) m², dhe i kërkon përfaqësuesit me prokurë të nënshkruajë për pjesën, që kompensohet.

e) Llogarit vlerën e sipërfaqes, që kompensohet.

ë) Përgatit relacionin, ku shpjegohet me hollësi për secilin subjekt kërkues të kompensimit:

i) vlefshmëria e vendimit të paraqitur nga subjekti;

ii) Vendimet e tjera, që vërtetojnë njohje dhe kthime të tjera të pronës për subjektin përkatës, shoqëruar me kopje të tyre;

iii) konfirmimet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

iv) vlerësimin e pronës për kompensim.

f) Dërgon konfirmimet e marra për personat, në bazë të vërtetimit të banimit të tyre.

7.2. Zyra e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në qendër shqyrton dokumentacionin e zyrave rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe:

a) përgatit vlerësimin ligjor të kompensimit;

b) harton relacionin përkatës;

c) merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar;

ç) i dërgon subjektit të shpronësuar, Avokatit të Shtetit dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të marra, për t'u dhënë mundësi të ushtrojnë kompetencat ligjore;

d) shpall listën e subjekteve fituese;

dh) kryen veprimet me thesarin dhe bankën për kalimin e fondit të kompensimit në të holla, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.

8. Procesi i regjistrimit/pranimi të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 30 ditë.

9. I gjithë procesi i trajtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara duhet të kryhet në përputhje me këtë vendim dhe me afatin ligjor, të përcaktuar në nenin 17/2 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

10. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre nga subjektet e shpronësuara, në zbatim të këtij vendimi, sjell përjashtimin e menjëhershëm të këtyre subjekteve nga procedura e kompensimit në të holla dhe i ngarkon ata me përgjegjësi penale, sipas ligjit.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe SAMT-të në rrethe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

K Ë R K E S Ë

PËR KOMPENSIMIN E PRONËS

Drejtuar: AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Data e paraqitjes së kërkesës ____ / ____ / 2009

Subjekti i shpronësuar :

_____	_____	_____
Emri	Atësia	Mbiemri

Personi me prokurë që paraqet kërkesën:

_____	_____	_____
Emri	Atësia	Mbiemri

Adresa e personit me prokurë:

_____	_____	_____
Qarku	Rrethi	Qyteti/fshati
_____	_____	_____
Lagja	Rruga	Nr.i banesës
_____	_____	_____
Telefon	Celular	e-mail

Kërkoj kompensimin e pronës me të holla, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr._____, datë ____/____/2009 “Për miratimin e procedurave të ndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2009”.

Kërkuesi

(emri, atësia, mbiemri, nënshkrimi)

SHËNIM : Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

DEKLARATË**Personi me prokurë që paraqet kërkesën :**

Emri _____	Atësia _____	Mbiemri _____
------------	--------------	---------------

Adresa e personit me prokurë :

Qarku _____	Rrethi _____	Qyteti/fshati _____
Lagja _____	Rruga _____	Nr.i banesës _____
Telefon _____	Celular _____	e-mail _____

Në emër të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, sipas prokurorisë së posaçme të bashkëlidhur, deklaroj se:

1. Në rast se nuk shpallem fitues, sipas kriterëve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.____, datë ____/____/2009 “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2009”, tërhiqen nga kërkesa e paraqitur për kompensimin në të holla për vitin 2009.
 2. Heq dorë nga e drejta e parablerjes për sipërfaqen e kompensuar, në rast se shpallem fitues në këtë aplikim.
 3. Nuk kam fituar nga kompensimet e mëparshme, nuk kam përfituar kthim fizik me vendim për njohjen dhe kthimin e pronës, si dhe nuk kam përfituar tokë nga zbatimi i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”.
 4. Nuk jam në proces gjyqësor, apo proces shqyrtimi të një ankimi administrativ në lidhje me pronën objekt kompensimi.
 5. Deklaroj që të gjithë trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, të cilët përfaqësoj me prokurë, janë gjallë (për subjektet që kanë aplikuar për kompensimin në të holla të pronës, për vitin 2008).
- Kjo deklaratë i bashkëlidhet kërkesës nr.____, datë ____/____/2009, për kompensim në të holla për vitin 2009.

Deklaruesi (përfaqësuesi me prokurë)

(emri, atësia, mbiemri, nënshkrimi)

SHËNIM : Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

MODELAR

I KONFIRMIMIT TË GJENDJES JURIDIKE TË PRONËS PËR KOMPENSIM
(për plotësim nga ZRKKP dhe ZVRPP)

Në zbatim të VKM nr. _____, datë _____. 2009 "Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2009", në përgjigje të kërkesës nr. _____, datë _____. 2009 të ZRKKP qarku _____, pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, ZVRPP _____ konfirmon lidhur me të dhënat e subjektit të shpronësuar (apo trashëgimtarët e tij) që ka aplikuar për kompensimin financiar 2009 :

Emri i subjektit të shpronësuar (ose i trashëgimtarëve të tij ligjorë) :
(për plotësim nga ZRKKP)

Numri dhe data e vendimit për kthimin dhe kompensimin e pronës :

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme konfirmon :
(për plotësim nga ZVRPP)

1. Vlefshmërinë e regjistrimit të vendimit përkatës në ZVRPP;

2. Verifikimin e ndryshimit të gjendjes juridike të pronës nga çasti i daljes së vendimit të paraqitur nga subjekti përkatës;

3. Verifikimin nëse subjekti i shpronësuar (apo trashëgimtarët e tij) ka të regjistruar ushtrimin e së drejtës së parablerjes;

4. Verifikimin nëse subjekti i shpronësuar ka të regjistruar pronë të përfutur me kthim nga vendimeve të tjerë të ish-KKKP-ve pranë ish-Këshillave të Rretheve e Bashkive apo të ZRKKP-ve në qarqe, në emër të tij.

PËR ZRKKP

PËR ZVRPP

VENDIM
Nr.498, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 438 , DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e vitit 2009, parashikuar për politikën për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	33 600	7 000
	Agjent i I-rë	36 500	7 000
	Asistent	39 000	8 000
	Asistent i I-rë	40 500	8 000
	Kryeasistent	43 00	8 000
I mesëm	Nëninspektor	47 000	6 000
	Ispektor	51 000	6 000
	Kryeinspektor	60 000	6 000
I lartë	Nënkomisar	69 000	6 000
	Komisar	82 000	6 000
	Kryekomisar	94 000	6 000
Madhor	Drejtues	105 000	
	Drejtues i I-rë	115 000	

VENDIM

Nr.526, datë 27.4.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË
PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË
SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE SHTABET
USHTARAKE NDËRKOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të këtij viti, të planifikuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

Emërtimi	Paga në euro	Paga në dollarë	Shtesa për përfaqësimin (në%)
Përfaqësitë e NATO-s			
Gj.Lejtnant	1170	1410	75 %
Gj.Major	1145	1365	60-75 %
Gj.Brigade	1070	1285	60-75 %
Përfaqësitë e tjera			
Kolonel	960	1165	40-60 %
Nënkolonel	910	1100	40-60 %
Major	865	1050	40 %
Kapiten	805	1020	40 %
Toger	760	925	40 %
Nëntoger	705	875	40 %
K/kapter	760	925	40 %
Kapter	680	820	40 %
Rreshter	560	655	40 %
Tetar	455	560	40 %
Nëntetar	405	505	40 %

VENDIM
Nr.527, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1315, DATË 1.10.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS PRANË QENDRËS “SECI””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.1315, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të zëvendësohet në lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të këtij viti, të planifikuara për politikën e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PAGA MUJORE E NËPUNËSVE NDËRLIDHËS TË MINISTRISË SË BRENDSHME E TË
MINISTRISË SË FINANCIVE, PRANË QENDRËS SECI**

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	Paga bazë mujore (në euro)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Nëpunës ndërlidhës	805 euro	40%

VENDIM
Nr.528, datë 27.4.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.932, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TE SHITESAVE MBI PAGË TË
PUNONJËSVE SHQIPTARË, PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI,
PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME, HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME, TË
ATASHUARA NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e viti 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.932, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të këtij viti, të planifikuara për politikën e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGA MUJORE E OFICERËVE TË KONTAKTIT, TË MINISTRISË SË BRENDSHME, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Oficer kontakti	805 euro 1020 dollarë USD	40%

**VENDIM
Nr.529, datë 27.4.2009**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.495, DATË 1.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që i përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.3, që i përmendet në pikën 8, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3/1, që përmendet në pikën 9, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të këtij viti, të planifikuara për politikën e pagave.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**PAGA MUJORE E PERSONELIT DIPLOMATIK TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA**

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë USD)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Ambasador	1250 euro 1520 dollarë USD	75 %
Konsull i Përgjithshëm	690 euro	75 %
Ministër Fuqiplotë	1165 dollarë USD	40 %
Ministër Këshilltar		40 %
Këshilltar	805 euro 1020 dollarë USD	40 %
Sekretar i parë	660 euro	40 %
Konsull	815 dollarë USD	
Sekretar i dytë	505 euro	40 %
Zëvendëskonsull	650 dollarë USD	
Sekretar i tretë	455 euro	40 %
Agjent Konsull	560 dollarë USD	
Atashe	405 euro	40 %
	505 dollarë USD	

**PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PLOTË),
TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA**

Pozicioni	Paga mujore				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar teknik	820 euro	780 euro	750 euro	725 euro	670 euro
Financier	920 dollarë	885 dollarë	850 dollarë	830 dollarë	780 dollarë
Specialist	USD	USD	USD	USD	USD
Shofer	780 euro	740 euro	705 euro	680 euro	630 euro
	885 dollarë	840 dollarë	810 dollarë	790 dollarë	735 dollarë
	USD	USD	USD	USD	USD
Kafaz	650 euro	610 euro	575 euro	545 euro	500 euro
	715 dollarë	670 dollarë	640 dollarë	610 dollarë	560 dollarë
	USD	USD	USD	USD	USD

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PJESSHME), TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHETETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore (me kohë të pjesshme)	
	Minimumi	Maksimumi
Sekretar teknik	290 euro	440 euro
Financier	320 dollarë USD	490 dollarë USD
Specialist		
pastrues	220 euro	295 euro
	240 dollarë USD	325 dollarë USD

VENDIM
Nr.530, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1 (Krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8.), të përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr. 2, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për punonjësit në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave të vitit 2009, ndërsa për punonjësit në varësi të ISKSH-së të përballohen nga Instituti i Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrotjtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK
GJINEKOLOGJIK TIRANË, SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRISË “SHEFQET NDROQI”
TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiere		2%	0	28000	3600	Nga...deri...lekë
2	Kryeinfermier shërbimi psikiatrik		2%	0	28000	6000	
3	Kryelaborant në shërbimin e anatomisë patologjike. Kryeinfermier shërbimi i terapisë intensive. Kryeinfermiere shërbimi onkologjik. Kryelaborant rrezatim kobalti. Kryelaborant në histopatologji. Kryeinfermierë të repartit të rrezatimit.		2%	0	28000	3400	Nga...deri...lekë
4	Kryeinfermierë repartit psikiatrik.		2%	0	28000	5000	Nga...deri...lekë
5	Kryeinfermierë shërbimi neurokirurgji. Kryemami e përgjithshme. Kryeinfermier/kryemami repartit i terapisë intensive		2%	0	28000	2600	Nga...deri...lekë
6	Kryeinfermierë kimioterapi. Kryelaborant klinik biokimik. Kryeinfermierë në urgjencën e sëmundjeve të brendshme. Kryeinfermiere/mami salle. Kryeinfermiere/mami e dhomës së zgjimit. Infermierë në hemodinamikë. Kryelaborant imunolog, bakteriolog.		2%	0	28000	1800	Nga...deri...lekë
7	Kryeinfermierë shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastik, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektive, obstetrik).		2%	0	28000	1100	Nga...deri...lekë

	Kryeinfermier/kryemami në repartin e kirurgjisë Kryemami turni në kirurgji Kryemami turni në obsetrikë. Kryeinfermierë reparti infektiv. Kryeinfermierë reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji). Kryeinfermiere/kryemami salle operacioni.						
8	Kryeinfermierë shërbimi. Kryelaborantë shërbimi. Kryemami shërbimi		2%	0	28000		Nga...deri...lekë
9	Infermiere/laborant në psikiatri.		2%	0	26500	5000	Nga...deri...lekë
10	Infermierë në kyriterapi Laborant histopatolog.		2%	0	26500	3400	Nga...deri...lekë
11	Infermiere/Mami reanimacioni, neonatologji Infermiere në dhomën e zgjimit.		2%	0	26500	2650	Nga...deri...lekë
12	Infermiere në kimioterapi		2%	0	26500	1800	Nga...deri...lekë
13	Kryelaborant radiologjie		2%	0	26500	1500	Nga...deri...lekë
14	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiore. Kryeinfermiere e edukimit shëndetësor TB.		2%	0	26500	1100	Nga...deri...lekë
15	Kryeinfermier në repartin e alergologjisë. Kryeinfermierë në sterilizim. Kryemami në izolim.		2%	0	26500		Nga...deri...lekë
16	Laborant radiolog në onkologji		2%	0	23000	3700	Nga...deri...lekë
17	Laborant rezatim kobalti		2%	0	23000	3400	Nga...deri...lekë
18	Laborant në mjekësinë bërthamore		2%	0	23000	2650	Nga...deri...lekë
19	Infermierë në njësinë e inspektoratit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale. Infermierë në sallën e operacionit.		2%	0	23000	2100	Nga...deri...lekë
20	Kryeinfermier reparti pranim urgjence Laborant kimik biokimik. Infermier në punktin e gjakut. Infermier në hematologji. Infermier në onkologji Infermiere endoskopie Infermier/laborant bakterilog, imunolog.		2%	0	23000	1800	Nga...deri...lekë
21	Infermiere reparti radiologjik		2%	0	23000	1500	Nga...deri...lekë

	Laborant radiolog. Kryeinfermiere (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji)						
22	Infermiere/mami (Kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike). Isntrumentarë.		2%	0	23000	1100	Nga...deri...lekë
23	Kryeinfermierë neonatologji. Kryemami në qendrën e gruas. Kryemami pranimi Kryeinfermiere në kabinetin e dializës. Kryemami /Kryeinfermierë reparti. Kryeinfermierë konsultash në sëmundjet e brendshme. Kryelaborant bakterolog, imunolog, ortopedi stomatologjike) Infermierë sterilizimi.		2%	0	23000		Nga...deri...lekë
24	Infermierë pavioni rezatimi		2%	0	22000	3310	Nga...deri...lekë
25	Infermierë (infektiv, pranim urgjence, njësia e kordinimit të urgjencës)		2%	0	22000	1800	Nga...deri...lekë
26	Ndihmësfarmacist Infermierë në hemodializë.		2%	0	22000	1500	Nga...deri...lekë
27	Infermier fizioterapi		2%	0	22000	1100	Nga...deri...lekë
28	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji) Kryeinfermierë çerdhe për personelin. Infermier Infermier çerdhe për personelin Kujdestar në pediatri		2%	0	22000		Nga...deri...lekë
29	Kujdestar në psikiatri		2%	0	19000	5000	Nga...deri...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË
RAJONALE TË SHËNDETËSISË, DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE,
AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermierore		2%	0	28000		Nga...deri...lekë
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermierore Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	26500		
3	Ndihmësinjektor sanitar, ndihmëshigjienist, Ndihmësepidemiolog Laborant toksikologë		2%	0	23000	1100	
4	Infermierë në shërbimet e shëndetit mendor		2%	0	23000	5000	
5	Infermierë (hematologji, onkologji) Laborant rontgeni		2%	0	23000	1500	
6	Infermier statistike		2%	0	22000		
7	Infermier ortopedi Infermier/laborant në fizioterapi		2%	0	22000	1100	
8	Kryeinfermier/kryemami Infermier në shërbimin stomatologjik Laborant bakterolog/klinik biokimik Ndihmësdentist		2%	0	22000		
9	Ndihmësbakterolog Infermier/mami		2%	0	19000		

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË SPITALET E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE TANË

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike.		2%	0	28000	6000	Nga...deri...lekë
2	Kryeinfermier reparti në spitale psikiatrike		2%	0	28000	5000	
3	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	28000	1100	
4	Laborant në anatominë patologjike		2%	0	26500	3400	
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakterologjik Kryeinfermier (kirurgji, reanimacion, sallë operacioni, obsetrikë gjinekologji)		2%	0	26500	1100	
6	Kryeinfermier		2%	0	26500		
7	Infermiere në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	23000	5000	
8	Infermiere reanimacioni Ndhmësanestezistë Ndhmësfarmacistë Laborant radiologjier Infermiere në radiologji Instrumentare Infermiere në hemodializë		2%	0	22000	1500	
9	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit. Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanceri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji, pneumoftiziatri, onkologji, dispanceri) Infermierë në repartin e lindjes. Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji.		2%	0	22000	1100	

	Përgjegjës turni.						
10	Kryeinfermiere në qendrën e sterilizimit. Infermier pranim urgjence. Laborant klinik biokimik/bakteriologjik.		2%	0	22000	600	
11	Infermier		2%	0	22000		
12	Kujdestar në psikiatri		2%	0	19000	5000	
13	Kujdestar në pediatri Ndihmësinfermier		2%	0	19000		

Lidhja nr.1 (Kreu 1.4)

STRUKTURA E PAGAVE PËR LABORANTËT NË LABORATORIN E KONTROLLIT TË BARNAVE

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Laborant		2%	0	28000		Nga...deri...lekë

Lidhja nr.1 (Kreu 1.5)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË KLINIKËN E SHËRBIMEVE MJEKËSORE

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier		2%	0	28000		Nga...deri...lekë
2	Infermier Ndihmësstomatologë		2%	0	22000		Nga...deri...lekë

Lidhja nr.1 (Kreu 1.6)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË GJAKUT**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier kryelaborant		2%	0	26500		Nga...deri...lekë
2	Infermier Laborant		2%	0	22000	1100	Nga...deri...lekë

Lidhja nr.1 (Kreu 1.7)

Struktura e pagave për teknikët në njësinë e transportit mjekësor me helikopterë

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm Teknik elektrik		2%	0	26500		Nga...deri...lekë

Lidhja nr.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

GRUPI		PAGA NË LEKË
1	Diplomë e shkollës së lartë	10000
2	Diplomë e shkollës së mesme	8000
3	Dëftesë lirimi (arsimi 8/9-vjeçar) dhe kurse infermierie	6000

VENDIM
Nr.533, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1092, DATË 2.07.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË DOGANAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1092, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagave të sistemit doganor”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e doganave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Vlera e pagës së grupit prej 11 000 (njëmbëdhjetë mijë) lekësh, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, të planifikuara për rritjen e pagave.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË
DOGANAVE

PAGA MUJORE							
Klasifikimi doganor	Pozicioni	Kategoria	Paga individuale			Shtesa e pozicionit	
			Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetësi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune
	Titullari i institucionit	II-a	12 000	2%	0	105 000	20 000
	Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	12 000	2%	0	88 000	15 000
A	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë	III-a	12 000	2%	0	69 000	15 000
B	Përgjegjës/shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës	III-a/1	12 000	2%	0	60 000	14 000

C1	Inspektor kontrolli i brendshëm. koordinator në DOH. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabande. Specialist laborator. Specialist, jurist, administrator rrjeti.	III-b	12 000	2 %	0	52 000	14 000
	Finacier në degën doganore, Përkthues, Koordinator në DOH, Specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare	III-b	12 000	2 %	0	52 000	12 000
C2	Doganier kontrolli dokumentar fizik. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator. Llogaritar.	IV-a	12 000	2 %	0	41 000	12 000
C3	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretare. Arkivist.			1 %		34 000	8000
D1	Magaziner. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik.					29 000	4500
D2	Punëtor mirëmbajtës					19 600	4000
D3	Punonjës pastrimi					18 000	1000

VENDIM
Nr.581, datë 28.5.2009

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 28 QERSHORIT TË VITIT 2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në buxhetin e vitit 2009, për përballimin e shpenzimeve për zgjedhjet e 28 qershorit, t’i shtohet fondi 165 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, i ndarë, në zërat, si më poshtë vijon:

- 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë, për paga e sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për mallra e shërbime;
- 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, për t’ua shpërndarë subjekteve zgjedhore.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të viti 2009.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.582, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, DHE TË SPITALIT USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR , NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit 10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Lidhja nr.1 (Krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 e 1.9), zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Vlera e pagesës së një ore pune të kontraktuar të jetë e njëjtë me vlerën orare të pozicionit të punës, për të cilin është kontraktuar.”.

c) Në pikën 2, vlera “... 11 000 lekë në muaj...” zëvendësohet me “...12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj...”.

ç) Shkronjat “a” e “b” të pikës 9, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Për çdo shërbim roje 24 orë pa ndërprerje u jepet shpërblim në masën e mëposhtme:

i) Në qendrat spitalore universitare:

	Mjek roje i parë	Mjek roje i dytë
- Për ditët e zakonshme	3000	2800;
- Për ditët e shtuna	3500	3200;
- Për ditët e diela e festat	4000	3800.

ii) Në institucionet e tjera

	Mjek roje i parë	Mjek roje i dytë
- Për ditët e zakonshme	2800	2600;
- Për ditët e shtuna	3000	2800;
- Për ditët e diela e festat	3500	3300.

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, të organizuar dhe që funksionon si i tillë, u jepet, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, një shpërblim, në masën e mëposhtme:

	Në ditët e zakonshme	e shtuna	e diela e festa
- Për sistemin 24 orë	2300	2400	2700;
- Për sistemin 16 orë	2000	2300	2400;
- Për sistemin 12 orë	1800	2000	2300.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për punonjësit në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2009, për rritjen e pagave, ndërsa për punonjësit në varësi të ISKSH-së, të përballohen nga Instituti i Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja 1 (Kreu 1.1.)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN SPITALORE
UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALI UNIVERSITAR OBSETRIK
GJINEKOLOGJIK NR.1, NR.2 TIRANË, SPITALI UNIVERSITAR I SËMUNDJEVE TË
MUSHKËRIVE “SHFEQET NDROQI” TIRANË, KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE
TIRANË, SPITALI USHTRAK QENDROR UNIVERSITAR TIRANË

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	- Drejtor - QSU “Nënë Tereza” Tiranë - Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë - Spitali Universitar Osetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” Tiranë - Spitali i Sëmundjeve të Mushkrisë “Shefqet Ndroqi	12 000	2%	0	88 000		Nga...deri lekë
2	Drejtor -Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë - Zëvendësdyrejtor i QSU “Nënë Tereza” Tiranë	12 000	2%	0	69 000		
3	Zëvendësdyrejtor në spitalet e tjera universitare	12 000	2%	0	60 000		Nga...deri ...lekë
4	Shef shërbimi Shef i sektorit biomedikal	12 000	2%	0	52 000		Nga...deri ...lekë
5	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.) Shef i qendrës së gruas	12 000	2%	0	45 000		Nga...deri ...lekë
6	Shef reparti/klinike reanimacioni	12 000	2%	0	45 000	1 100	Nga...deri ...lekë
7	Shef reparti/klinike spikiatrie	12 000	2%	0	45 000	5 000	Nga...deri ...lekë

8	Shëf laboratorit klinik biokimik Shëf reparti kimioterapi Shëf laboratorit Shëf i qendrës së diagnozës molekulare	12 000	2%	0	45 000	2 200	Nga...deri ...lekë
9	Shëf reparti rezatimi Shëf reparti i kyrisë	12 000	2%	0	45 000	4 600	Nga...deri ...lekë
10	Shëf kabinetit Shëf i qendrës së protezimit Inxhinier biomedikale	12 000	2%	0	41 000		Nga...deri ...lekë
11	Shëf sektori Shëf farmacie në solucionet e injektueshme Biokimist në solucionet e injektueshme Inxhinier i sistemeve të ngrohjes. Inxhinier hemodialize	12 000	2%	0	41 000		Nga...deri ...lekë
12	Mjek Stomatolog Biolog, kimist, fizikant në preparatorit Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog. Përgjegjës qendre DDD Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji).	12 000	2%	0	35 000		Nga...deri ...lekë
13	Mjek kirurg (specialist kirurgjikale) Mjek onkolog Mjek fizioterapevt Mjek obsetër gjinekolog Mjek pneumoftiziatër	12 000	2%	0	35 000	1 100	Nga...deri ...lekë
14	Mjek radiolog toksikolog, kimist në laboratorin toksikologjik Kimist në laboratorin biokimik Fizikat në laboratorin biokimik Biolog në laboratorin biokimik	12 000	2%	0	35 000	1 600	Nga...deri ...lekë
15	Mjek kimioterapevt Mjek hematolog Mjek infeksionist Mjek në pranim kurgjence Mjek në njësinë nozokomiale Mjek laboratorit Mjek histopatolog Mjek në shërbimin e gjakut	12 000	2%	0	35 000	2 000	Nga...deri ...lekë
16	Mjek në inspektoriatin sanitar. Inspektor sanitar Epidemilog Farmacist	12 000	2%	0	35 000	2 500	Nga...deri ...lekë
17	Farmacist në laboratorin toksikologjik Mjek laboratorit izotopik Fizikant, kimist laboratorit izotopik Mjek në hemodinamikë Fizikant në higjienën dhe hepidemilogji	12 000	2%	0	35 000	2 800	Nga...deri ...lekë

	Inxh kimist në shërbimin e higjenës së SUQU Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike në SUQU						
18	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziat, reanimator Mjek në pavionin e rrezatimit Mjek në pavionin e kyrisë Specialist në qendrën e diagnozës molekulare Fizikant kobalti	12 000	2%	0	35 000	3 700	Nga...deri ...lekë
19	Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në psikiatri	12 000	2%	0	35 000	5 000	Nga...deri ...lekë
20	Inspektor auditi	12 000	2%	0	31 000		Nga...deri ...lekë
21	Specialist i lartë	12 000	2%	0	27 000		Nga...deri ...lekë

Lidhja 1 (Kreu 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËNDETËSISË, DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Titullar i drejtorive rajonale. Titullar në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës	12 000	2%		69 000	9 000	Nga...deri ...lekë
2	Drejtor dhe kryeinspektor sanitar në drejtoritë e shëndetit publik në rrethe.	12 000	2%		60 000	9 000	
3	Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të shëndetësisë dhe drejtor i drejtorive të shëndetit publik në rrethe.	12 000	2%		52 000		Nga...deri lekë
4	Zëvendëstitullar në drejtoritë rajonale, në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës, në drejtoritë e shëndetit publik në rrethe.	12 000	2%		52 000		Nga...deri lekë
5	Shef shërbimi i kujdesit parësor. Shef shërbimi urgjence Shef shërbimi i mjekësisë familjare	12 000	2%		41 000		Nga...deri lekë
6	Shef shërbimi i higjenës Shef shërbimi i epidemiologjisë	12 000	2%		41 000	9 000	Nga...deri lekë
7	Shef shërbimi stomatologjik.	12 000	2%		41 000	3 300	Nga...deri lekë
8	Shef sektori Shef reparti Shef kabineti	12 000	2%		31 000		Nga...deri lekë

	Shef/përgjegjës laborator Përgjegjës dispancerie						
9	Specialist i lartë në higjienë. Specialist i lartë në epidemilogji	12 000	2%		31 000	7 000	Nga...deri lekë
10	Epidemiolog Higjenist	12 000	2%		31 000	8 000	Nga...deri lekë
11	Inspektor stomatolog	12 000	2%		31 000	11 00	Nga...deri lekë
12	Shef reparti/laborator në higjienë Shef reparti/laboratori në epidemilogji.	12 000	2%		31 000	9 000	Nga...deri lekë
13	Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor	12 000	2%		31 000	5 000	Nga...deri ...lekë
14	Mjek Stomatolog Inxhinier elektrik Kimist Veteriner Mikrobiolog	12 000	2%		31 000		Nga...deri ...lekë
15	Mjek fizioterapevt Mjek kirurg Mjek ortoped Mjek pneumoftiziatër	12 000	2%		31 000	1 100	Nga...deri ...lekë
16	Mjek radiolog Mjek hematolog Mjek onkolog	12 000	2%		31 000	1600	Nga...deri ...lekë
17	Mjek psikolog, punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor	12 000	2%		31 000	5 000	Nga...deri ...lekë
18	Përgjegjës zyre Inspektor	12 000	2%		31 000	1 100	Nga...deri ...lekë
19	Specialist me arsim të lartë	12 000	2%		25 000		Nga...deri ...lekë
20	Specialist i lartë promocioni	11 000	2%		25 000	4 000	Nga...deri ...lekë

Lidhja 1 (Kreu 1.3)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË SPITALET E
RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	12000	2%		69000		Nga...deri ...lekë
2	Shef shërbimi në anatomopatologji	12000	2%		45000	3500	Nga...deri ...lekë
3	Zëvendësdrejtor Shef shërbimi	12000	2%		41000		Nga...deri ...lekë

4	Shef shërbimi reanimacioni Shef shërbimi infektiv Shef shërbimi obsetrik gjinekologjik Shef shërbimi kirurgji Shef shërbimi ortopedi	12000	2%		41000	1100	Nga...deri ...lekë
5	Shef shërbimi radiologji Shef shërbimi neuropsikiatri	12000	2%		41000	1600	Nga...deri ...lekë
6	Shef shërbimi psikiatri	12000	2%		41000	5000	Nga...deri ...lekë
7	Shef reparti/klinike Përgjegjës/shef kabineti Përgjegjës/shef laboratori/poliklinike/fizioterapi	12000	2%		31000		Nga...deri ...lekë
8	Shef i bankës së gjakut Shef reparti radiologjie Shef reparti pneumoftiziatri	12000	2%		31000	1100	Nga...deri ...lekë
9	Shef reparti/klinike psikiatri	12000	2%		31000	5000	Nga...deri ...lekë
10	Përgjegjës laboratorit klinik biokimik	12000	2%		31000	2500	Nga...deri ...lekë
11	Përgjegjës/shef reparti anatomopatologji	12000	2%		31000	3700	Nga...deri ...lekë
12	Mjek Stomatolog Biolog Kimist Fizikant Shef sektori Përgjegjës zyre Inxhinier biomedikal	12000	2%		31000		Nga...deri ...lekë
13	Mjek infeksionist Mjek urgjence Mjek laboratorit Kimist, fizikant laboratorit Kimist në shërbimin e gjakut	12000	2%		31000	600	Nga...deri ...lekë
14	Mjek onkolog Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale) Mjek hematolog Mjek i bankës së gjakut Mjek obsetër-gjinekolog Mjek pneumoftiziatër Mjek fizioterapeut	12000	2%		31000	1100	Nga...deri ...lekë
15	Mjek radiolog	12000	2%		31000	1600	Nga...deri ...lekë
16	Mjek higjienist Farmacist	12000	2%		31000	2500	Nga...deri ...lekë
17	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziatist-reanimator	12000	2%		31000	3700	Nga...deri ...lekë
18	Mjek, psikolog, punonjës social që punojnë në psikiatri	12000	2%		31000	5000	Nga...deri ...lekë
19	Specialist i lartë	12000	2%		25000		Nga...deri ...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shetsa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	12000	2%		69000		Nga...deri ...lekë
2	Zëvendësdrejtor	12000	2%		60000		Nga...deri ...lekë
3	Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave	12000	2%		52000		Nga...deri ...lekë
4	Shef sektori në sektorët e tjerë	12000	2%		41000		Nga...deri ...lekë
5	Farmacist Analist	12000	2%		41000	4000	Nga...deri ...lekë
6	Farmacist inspektor për kontrollin farmaceutik	12000	2%		41000	5000	Nga...deri ...lekë
7	Specialist i lartë	12000	2%		25000		Nga...deri ...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
SHËRBIMEVE MJEKËSORE**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shetsa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	12000	2%		52000		Nga...deri ...lekë
2	Shef sektori	12000	2%		41000		Nga...deri ...lekë
3	Mjek stomatolog	12000	2%		31000		Nga...deri ...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
INXHINIERISË BIOMJEKËSORE**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shetsa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	12000	2%		55000		Nga...deri ...lekë
2	Shef sektori	12000	2%		41000		Nga...deri ...lekë
3	Përgjegjës i zyrës teknike Përgjegjës reparti	12000	2%		35000		Nga...deri ...lekë
4	Specialist i lartë	12000	2%		25000		Nga...deri ...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
TRANSFUZIONIT TË GJAKUT**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shetsa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	12000	2%		69000		Nga...deri ...lekë
2	Zëvendësdrejtor	12000	2%		45000		Nga...deri ...lekë
3	Përgjegjës i sektorit të laboratorëve Shef i bankës së gjakut	12000	2%		41000	2500	Nga...deri ...lekë
4	Shef sektori	12000	2%		31000		Nga...deri ...lekë
5	Mjek kimist	12000	2%		31000	1100	Nga...deri ...lekë
6	Specialist i lartë	12000	2%		25000		Nga...deri ...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË NJËSINË E
TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shetsa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i njësisë	12000	2%		71000		Nga...deri ...lekë
2	Kryepilot	12000	2%		71000	8000	Nga...deri ...lekë
3	Pilot	12000	2%		67000	8000	Nga...deri ...lekë
4	Teknik helikopter	12000	2%		64000		Nga...deri ...lekë
5	Shef sektori	12000	2%		35000		Nga...deri ...lekë
6	Specialist i lartë	12000	2%		25000		Nga...deri ...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE
SHËNDETËSORE**

		Paga mujore					
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit		
	Emërtimi	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shetsa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	12000	2%		88000		Nga...deri ...lekë
2	Shef sektori	12000	2%		52000		Nga...deri ...lekë
3	Specialist i lartë	12000	2%		41000		Nga...deri ...lekë

VENDIM
Nr.2, datë 6.1.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Gani Dizdari	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Evjeni Sinoimeri	Anëtar
Irma Bala	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtar
Aleksander Muskaj	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 6.01.2009 morën në shqyrtim çështjen civile nr.5/3 që u përket:

PADITËSA: Neim Tuxhari, Maksim Tuxhari, *në mungesë*

TË PADITUR: Luan Belortaja, Nasibe Rovi, Pranvera Bitincka, Floresha Haxhimemin (Belortaja), Sadie Aziz, Yrmet Belortaja, Fitret Belortaja, Fatmir Belortaja, Pajtim Belortaja, Vjosa Cangonji, Burbuqe Koçibellinj (Cangonji), Vasfie Cangonji, Muazez Cangonji, Nexhat Cangonji, Arben Cangonji, Nexhmije Cangonji (Shkurti), Dilaviz Cangonji, Kujtim Cangonji, Qefser Cangonji, Lulzim Belortaja, Jeta Belortaja, Azim Goskova, Nebaet Goskova (Shahu), Afërdita Goskova, Gentian Goskova, Klejdi Goskova, Remzi Cuke, Shefqet Cuke, Bardhyl Cuke, Gëzim Cuke, *në mungesë*.

Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Korçë, në mungesë

OBJEKTI I PADISË: *Ndryshimin e vendimit nr.290, datë 10.12.2007 të ZRKK Pronave qarku Korçë, pika a.1 për sipërfaqen prej 10 000 m², ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të ish KKKP Bashkia Korçë, detyrimin për njohjen dhe kthimin e sipërfaqes prej 10 000 m².*

BAZA LIGJORE: *Neni 141/2 i Kodi i Procedurave Administrative; neni 328 i Kodi i Procedurës Civile; ligji nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1086, datë 22.04.2008, ka vendosur:

“Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes me palë paditëse: Neim Tuxhari, Maksim Tuxhari; të paditur: Luan Belortaja, Nasibe Rovi, Pranvera Bitincka, Floresha Haxhimemin (Belortaja), Sadie Aziz, Yrmet Belortaja, Fitret Belortaja, Fatmir Belortaja, Pajtim Belortaja, Vjosa Cangonji, Burbuqe Koçibellinj (Cangonji), Vasfie Cangonji, Muazez Cangonji, Nexhat Cangonji, Arben Cangonji, Nexhmije Cangonji (Shkurti), Dilaviz Cangonji, Kujtim Cangonji, Qefser Cangonji, Lulzim Belortaja, Jeta Belortaja, Gëzim Goskova, Nebaet Goskova (Shahu), Afërdita Goskova, Gentian Goskova, Klejdi Goskova, Remzi Cuke, Shefqet Cuke, Bardhyl Cuke, Gëzim Cuke, Zyra Rajonale e Kthimit Kompensimit të Pronave Qarku Korçë; me objekt: Ndryshimin e vendimit nr.290, datë 10.12.2007 të Z.R.K.K.Pronave Qarku Korçë pika a/1 për sipërfaqen prej 10.000 m², ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të ish K.K.K.P. Bashkia Korçë, detyrimin për njohjen dhe kthimin e sipërfaqes prej 10.000 m²”.

Kundër vendimit të mësipërm të gjykatës së rrethit gjyqësor kanë ushtruar ankim të veçantë paditësat Neim Tuxhari dhe Maksim Tuxhari, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në seancën gjyqësore të datës 30.10.2008 ka vendosur kalimin e çështjes civile nr.11111-01942-00-2008 te regj.themeltar, për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Shpresa Beçaj dhe Andi Çeliku; në mungesë të palëve ndërgjyqëse dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Paditësit, Neim Tuxhari dhe Maksim Tuxhari, kanë paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë padinë me objekt ndryshimin e vendimit nr.290, datë 10.12.2007 të ZRKK Pronave qarku Korçë, pika a.1 për sipërfaqen prej 10 000 m²; ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të ish - KKKP bashkia Korçë; detyrimin e të paditurve (trashëgimtarë të Sadik Belortasë) për njohjen dhe kthimin e sipërfaqes prej 10 000 m², bazuar në nenin 141/2 të K.Pr.Administrative, nenin 328 të *Kodit të Procedurës Civile*, ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*”.

Zyra rajonale e kthimit dhe kompensimit të pronave qarku Korçë, me vendimin nr.290, datë 10.12.2007, pasi ka shqyrtuar kërkesën e tyre, me cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarit Shefqet Abedin Tunxhari, në pikën a/1 ka vendosur: *“Të mos njohë të drejtën e pronësisë për pronën truell me sipërfaqe të përgjithshme 13.322 m² ndodhur në Korçë, në vendin e quajtur “Udha e Qatromit”, për arsye se truelli me sipërfaqe 10 000 m² i ndodhur tek pasuritë nr.1/29, 110/1, 120/2 i është njohur me vendimin nr.1542, datë 27.08.1996 të KKP bashkia Korçë në favor të ish-pronarit Sadik Belortaja”*.

Gjithashtu paditësit kanë pretenduar se arsyetimi në vendimin e zyrës rajonale të KK Pronave qarku Korçë nuk është korrekt dhe i bazuar në ligj, pasi prona e pretenduar prej tyre në realitet nuk shkakton mbivendosje në pronën e trajtuar në favor të ish-pronarit Sadik Belortaja (trashëgimlënësi i të paditurve). Në vijim të këtij pretendimi, pala paditëse ka pretenduar se prona e tyre figuron e regjistruar qysh në vitin 1929, ku trashëgimlënësi i tyre Shefqet Abedini del kufitar jugor i Aliqemal Abedinit, ndërkohë që pala e paditur ka paraqitur në komision si vërtetim pronësie një vendim gjyqësor me objekt vërtetim fakti pronësie për sipërfaqen prej 10 000 m².

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr.1086, datë 22.04.2008, ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjen civile të mësipërme me arsyetimin se: *“... pala paditëse paraprakisht duhet të konsumojë ankimin e saj ndaj vendimit nr.290, datë 10.12.2007 dhe vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të zyrës rajonale të kthimit e kompensimit të pronave Korçë, në rrugë administrative, duke paraqitur kërkesën e saj ankimore për shqyrtim pranë AKKP Tiranë ...”*.

Në ankimin e veçantë të paraqitur para Gjykatës së Lartë, paditësat Neim Tuxhari dhe Maksim Tuxhari, kanë kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë, duke pretenduar se çështja objekt gjykimi është në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ, siç ka vendosur gjykata.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe duke pasur parasysh se në praktikë kanë lindur keqkuptime lidhur me zbatimin e nenit 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*”, i ndryshuar, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore, duke shtruar për zgjidhje këto pyetje:

1. *Në rastin kur sendi i pretenduar nga subjektet e shpronësuar, me vendim të organit kompetent (ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave, ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, ish-Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyrat rajonale të AKKP-së dhe AKK Pronave), i është njohur dhe kthyer subjekteve të tjera të shpronësuar, subjekti që pretendon të njëjtin send, duhet t'i drejtohet detyrimisht zyrës rajonale dhe AKKP Tiranë?*

2. *Subjektet e cituara më sipër, duhet të ndjekin procedurën e plotë administrative të ankimit, apo mund t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës duke kërkuar anulimin e vendimit të komisionit apo zyrës rajonale dhe kthimin e sendit?*

3. Lidhur me këto pyetje, referuar nenit 42 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nëse do të pranohej në rastin e mësipërm juridiksioni administrativ, a do të ishin, kërkesa drejtuar zyrës rajonale, si dhe ankimet përkatëse, “mjete efektive” në duart e subjekteve të shpronësuar, ndërkohë që këto subjekte paraprakisht e dinë që do të marrin përgjigje negative, për shkak se sendi i është kthyer një subjekti tjetër të shpronësuar? Si duhet kuptuar në këtë rast parashikimi i bërë në nenin 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, lidhur me ushtrimin e “ankimit efektiv” nga subjektet e shpronësuar kur sendi i pretenduar prej tyre është trajtuar me vendime të organeve kompetente në favor të subjekteve të tjera të shpronësuar?

Në nenin 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Kundër vendimit të njohjes të së drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar, ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në zyrën e AKKP-së në qendër. Kundër vendimit të njohjes të së drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim në zyrën e AKKP-së në qendër. Jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi i ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së merr vendim për objektin e ankimit.

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ka të drejtë të shqyrtojë kryesisht, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark. Drejtori i Përgjithshëm shqyrton edhe vendimet e dhëna nga ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve. Pas shqyrtimit kryesisht ose shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

- a) lëniën në fuqi të vendimit;
- b) shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij;
- c) kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së.”.

2. Kundër vendimit të AKKP-së në qendër për kompensim të pronës, subjekti i shpronësuar ka të drejtë të bëjë ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi. AKKP-ja përfaqësohet në gjykim nga zyra e AKKP-së në qendër.

Për të nxjerrë një përfundim sa më të drejtë për njehsimin e praktikës gjyqësore lidhur me juridiksionin gjyqësor apo administrativ për shqyrtimin e ankimeve për kthimin e pronës, kur kjo pasuri i është kthyer më parë subjekteve të tjera të shpronësuar me vendime të organeve kompetente, është e nevojshme të bëhet një analizë e frymës së përgjithshme të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Ligji i përmendur, siç citohet më lart, ka disa dispozita procedurale që bëjnë të mundur zhvillimin e një procedure të plotë administrative për njohjen dhe kthimin apo kompensimin e pronave. Ai përcakton dhe ngarkon me detyra organet përkatëse administrative që shqyrtojnë kërkesat e njohjes së pronësisë dhe ankimet administrative, si dhe parashikon procedurën e ankimit administrativ dhe atë gjyqësor. Nga shqyrtimi i neneve 15-18 të ligjit dalin disa përfundime të rëndësishme që lidhen me juridiksionin administrativ.

Ligjvënësi ka pasur qëllim që me këto dispozita të vendosë procedura administrative sa më të hollësishme dhe rigorozë për organet administrative të specializuara dhe të ngarkuara me ligj që nxjerrin akte për njohjen dhe kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, organin epror që mbikëqyr procedurën administrative të nxjerrjes së akteve, dhe njëkohësisht kryen funksionin e rëndësishëm të shqyrtimit të ankimeve administrative kundër akteve të dhëna nga organet më të ulëta, dhe së fundi, të drejtën e ankimit në gjykatë të subjekteve të shpronësuar, duke kaluar çështja në juridiksionin gjyqësor. Në këtë mënyrë, ligji garanton të gjitha mundësitë juridike për kryerjen e dy procedurave ankimi me radhë njëra pas tjetrës, e para rruga e ankimit administrativ dhe e dyta rruga gjyqësore e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve.

Gjithashtu, ligjvënësi jep mundësinë e shqyrtimit të ankimeve si kundër akteve administrative të nxjerra nga ish-komisionet e rretheve dhe bashkive që i përkasin periudhës para vitit 2004 kur ka dalë ligji që është në fuqi me ndryshimet përkatëse, ashtu edhe të akteve të nxjerra nga ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave gjatë periudhës së ndryshimeve të këtij ligji.

Ky rivlerësim apo rishqyrtim administrativ i këtyre akteve, pavarësisht nga koha e nxjerrjes së tyre, lidhet me vullnetin dhe qëllimin e ligjvënësit që këto akte t'i nënshtrohen rregullisht rishikimit nëpërmjet ankimit administrativ, dhe në vijim t'iu japë mundësi juridike subjekteve të interesuara të ndjekin rrugën e ankimit gjyqësor. Po ashtu, ligjvënësi, për të garantuar një procedurë administrative objektive gjatë nxjerrjes së akteve dhe njëkohësisht për të hapur rrugën e një kontrolli të mëtijshëm të tyre nëpërmjet rishikimit gjyqësor, parashikon edhe shqyrtimin kryesisht nga organi epror administrativ të akteve të pronësisë të organeve më të ulëta korrente dhe të organeve të mëparshme.

Këto konkluzione të krijojnë bindjen se fryma e ligjit është ndjekja fillimisht e rrugës administrative për ankimin e akteve administrative për pronësinë dhe vetëm pasi të jetë ezauruar kjo rrugë, subjektet e shpronësuara dhe të interesuara kanë të drejtën të ushtrojnë ankimin ndaj këtyre akteve administrative në gjykatë.

Ligjvënësi u ka dhënë kompetencë të plotë organeve administrative të specializuara për shqyrtimin e ankimeve administrative, sepse këto organe i kanë të gjitha mundësitë ligjore dhe institucionale për kryerjen e një hetimi dhe verifikimi të plotë administrativ gjatë procedurës për nxjerrjen e akteve administrative për pronësinë. Kjo procedurë harmonizohet edhe me nenin 137/3 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ”*.

Për këto arsye, dispozitat procedurale të ankimit parashikuar në ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe ato të Kodit të Procedurave Administrative, krijojnë kuadrin e plotë ligjor për të nxjerrë përfundimin se: **Pala e interesuar në një procedurë administrative, ose e prekur nga një akt administrativ të dhënë në favor të një subjekti tjetër, duhet të ndjekë fillimisht rrugën administrative për kundërshtimin e tij dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë, ajo mund t'i drejtohet juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.**

Për çështjen e paraqitur për njehsimin e praktikës gjyqësore, pavarësisht se nuk parashikohet shprehimisht në dy ligjet e përmendura, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se duhet të kualifikohet me frymën e ligjit të trajtuar më sipër.

Subjekti pretendues, derisa nuk ka ndjekur procedurën e plotë për ankimin e aktit në organin epror administrativ sipas nenit 18 të ligjit dhe nenit 137 të Kodit të Procedurave Administrative, por kërkon drejtpërdrejt në gjykatë njohjen e saj nëpërmjet kundërshtimit të një akti administrativ në favor të një subjekti tjetër, paraqitet si një palë ose subjekt i ri kërkuar. Si i tillë, duhet të kërkojë fillimisht nxjerrjen e një akti nga organi kompetent administrativ nëpërmjet ankimit kundër aktit të kontestuar të njohjes së pronësisë dhe njëkohësisht të parashitë kërkesën dhe pretendimet e tij për të njëjtën pronë.

Në këtë mënyrë, kërkesa drejtuar zyrës rajonale dhe eventualisht ankimi nga subjekti pretendues kundër aktit administrativ të kontestuar, të dhënë në favor të një subjekti tjetër, janë *“mjete efektive”* të ankimit administrativ, sepse: *së pari*: e detyrojnë organin përkatës të rishikojë me prova dhe pretendime të reja aktin e mëparshëm administrativ të nxjerrë prej tij dhe *së dyti*: organi administrativ që shqyrton ankimin, si ai që ka nxjerrë aktin ashtu dhe organi epror i tij, sipas nenit 18 të ligjit të cituar më lart dhe nenit 146 të Kodit të Procedurave Administrative, ka në kompetencë të vendosë lënien në fuqi, shfuqizimin, ose ndryshimin e aktit administrativ të ankimit.

Meqenëse kjo procedurë nuk është ndjekur e plotë dhe duke kualifikuar çështjen në frymën e ligjit - se organet administrative i kanë të mundësitë dhe aftësitë profesionale për të kryer një hetim dhe verifikim administrativ të specializuar për njohjen dhe kthimin ose kompensimin e pronave - duhet që edhe këto subjekte t'i nënshtrohen kësaj procedure administrative.

Mbas përfundimit të procedurës së plotë të ankimit administrativ, subjekti i ri kërkuar dhe/ose eventualisht ai i kontestuar, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë. Pra rruga gjyqësore e ankimit mbetet gjithmonë e hapur dhe garanci për subjektin pretendues, por, pasi të ezaurohet më parë prej tij procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ në përputhje me dispozitat ligjore të sipërpërmendura.

Sipas neneve 325 dhe 332 të Kodit të Procedurës Civile gjykata është kompetente të shqyrtojë vetëm paligjshmërinë apo pathemelësinë e aktit administrativ të ankimit dhe jo të kryejë një hetim të plotë administrativ. Ankimi në gjykatë për anulimin pjesërisht ose tërësisht të një akti që i njeh të drejtën e pronësisë një subjekti tjetër të ndryshëm nga subjekti ankues, nënkupton që subjekti ankues, gjatë shqyrtimit gjyqësor të ankimit, kthehet edhe në subjekt kërkuar, sepse duhet të argumentojë njëkohësisht si paligjshmërinë e aktit administrativ të marrë në kundërshtim me interesat e tij, ashtu dhe ligjshmërinë e

kërkesës së tij të pretenduar për njohjen e pronësisë.

Një gjë e tillë e detyron gjykatën të hyjë në procedurat e njohjes të së drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës të subjektit pretendues, gjë që sipas ligjit nuk është në kompetencë të saj, por të organeve administrative.

Pra, në një rast të tillë gjykata do të zëvendësonte organet administrative të specializuara e të autorizuar me ligj për njohjen dhe kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe do të kryente hetime dhe procedura administrative që nuk janë prerogative e saj. Edhe po të marrim parasysh arsyetimin e drejtë ligjor se gjykimi i paligjshmërisë së aktit administrativ të ankimuar është në kompetencë të gjykatës, përsëri ky gjykim do të bëhej mbi bazën e shqyrtimit të pretendimit të një subjekti që nuk ka ndjekur procedurat administrative për njohje pronësie sipas ligjit, dhe rrjedhimisht nga gjykata do të shqyrtohej themeli i pretendimit të kërkuarit të ri dhe njohjen e tij si pronar, për të dalë në përfundimin e paligjshmërinë ose pathemelësisë së aktit të kontestuar, gjë që përsëri nuk është në kompetencë të gjykatës.

Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se: **Ankimi administrativ parashikuar në nenin 18 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” duhet kuptuar dhe zbatuar njëjloj si për ankimet nga subjekti kërkuar që ndjek procedurën e plotë administrative dhe nuk paraqiten subjekte të tjera kërkuese, ashtu dhe për ankimet nga një subjekt i ri pretendues kundër aktit administrativ të dhënë në favor të një subjekti tjetër, por që prek interesat e tij për të njëjtën pronë dhe nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimit të aktit. Në të dyja rastet, subjektet e shpronësuara janë të detyruara të ndjekin procedurat e ankimit administrativ dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë ligjore, mund t’i drejtohen gjykatës.**

Sa më sipër, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, çmohet si vendim i marrë në zbatim të drejtë të ligjit, për këtë shkak vendimi duhet të mbetet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

Lenien në fuqi të vendimit nr.1086, datë 22.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PAKICE

Ne gjyqtarët në pakicë, ndryshe nga qëndrimi i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, jemi të mendimit se vendimi nr.1086, datë 22.04.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja civile me palë paditëse: Neim Tuxhari, Maksim Tuxhari; të paditur: Luan Belortaja, Nasibe Rovi, Pranvera Bitincka, Floresha Haxhimemin (Belortaja), Sadie Aziz, Yrmet Belortaja, Fitret Belortaja, Fatmir Belortaja, Pajtim Belortaja, Vjosa Cangonji, Burbuqe Koçibellinj (Cangonji), Vafie Cangonji, Muazez Cangonji, Nexhat Cangonji, Arben Cangonji, Nexhmije Cangonji (Shkurti), Dilaviz Cangonji, Kujtim Cangonji, Qefser Cangonji, Lulzim Belortaja, Jeta Belortaja, Gëzim Goskova, Nebaet Goskova (Shahu), Afërdita Goskova, Gentian Goskova, Klejdi Goskova, Remzi Cuke, Shefqet Cuke, Bardhyl Cuke, Gëzim Cuke, zyra rajonale e kthimit dhe kompensimit të pronave qarku Korçë; me objekt: Ndryshimin e vendimit nr.290, datë 10.12.2007 të ZRKK Pronave qarku Korçë pika a/1 për sipërfaqen prej 10.000 m², ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të ish KKKP Bashkia Korçë, detyrimin për njohjen dhe kthimin e sipërfaqes prej 10 000 m², është një vendim i pambështetur në ligj, prandaj ai duhet të prishej dhe çështja t’i dërgohej po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se paditësit, Neim dhe Maksim Tuxhari, si trashëgimtarë të subjektit të shpronësuar Shefqet Abedin Tuxhari, i janë drejtuar zyrës rajonale të K.K.Pronave të qarkut Korçë, e cila me vendimin nr.22, datë 2.02.2007 ka njohur të drejtën e pronësisë

të subjektit të shpronësuar për truallin 13 900 m², ndërsa për truallin prej 10 000 m² nuk e ka njohur pronësinë, me arsyetimin se kjo sipërfaqe me vendimin nr.1542, datë 27.08.1996 të KKK Pronave të Bashkisë Korçë i është njohur e kthyer ish-pronarit Sadik Belortaja (trashëgimtarëve të tij).

Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë ankimuar vendimin e Zyrës Rajonale të KK Pronave Qarku Korçë pranë AKK Tiranë, e cila me vendimin nr.137, datë 23.07.2007 ka shfuqizuar vendimin nr.22, datë 2.02.2007 të ZRKKP Korçë dhe ka kthyer për rishqyrtim çështjen po pranë kësaj zyre.

Edhe pas rishqyrtimit, zyra rajonale e K.K.Korçë, me vendimin nr.290, datë 10.12.2007, për të njëjtin shkak, nuk ka njohur pronësinë e subjektit të shpronësuar Shefqet Abedin Tuxhari.

Pala paditëse, me pretendimin se vendimi i ZRKK Pronave qarku Korçë nuk është i bazuar në ligj dhe në gjendjen e faktit, pasi prona e pretenduar prej tyre nuk ka mbivendosje me pronën e trajtuar në favor të trashëgimtarëve të Sadik Belortasë dhe se prona jonë figuron e regjistruar që në vitin 1929, ndërsa të paditurit kanë paraqitur në komision një vendim gjyqësor me të cilin kanë vërtetuar faktin e pronësisë për sipërfaqen prej 10.000 m², i është drejtuar gjykatës duke kërkuar anulimin pjesërisht të vendimit nr.290, datë 10.12.2007 të ZRKK Pronave dhe ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.1542, datë 27.08.1996 të KKKP, si dhe detyrimin për njohje pronësie dhe kthimin e sipërfaqes prej 10 000 m² të përfutur nga pala e paditur.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1086, datë 22.04.2008, ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjen objekt gjykimi.

Në arsyetim të vendimit, gjykata parashtron se pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimit ndaj vendimit të zyrës rajonale të K K Pronave qarku Korçë në Agjencinë qendrore të KK Pronave Tiranë.

Sipas ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar me ligjin nr.9684, datë 6.02.2007, në pikën “... 1/c të këtij ligji është përcaktuar se zyra e AKKP në qendër shqyrtton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të KKP në qark apo ish-komisionit vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

“Rregullimi ligjor i shprehur në nenin 1 të ligjit 9684, date 2.02.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004, ... si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.747, datë 9.11.2006, në referencë të nenit 18 dhe 136 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se mbrojtja ligjore e të drejtave të palës paditëse me cilësinë e një subjekti të shpronësuar do të realizohet duke ia nënshtruar vendimarrjen e zyrës rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave qarku Korçë kontrollit të brendshëm administrativ në organin epror, i cili në rastin konkret është Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të pronave Tiranë”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe duke pasur parasysh se në praktikë kanë lindur keqkuptime lidhur me zbatimin e nenit 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar dhe se këto keqkuptime mund të çojnë në qëndrime të ndryshme për çështje të ngjashme; si dhe duke mbajtur në vëmendje numrin e konsiderueshëm të çështjeve për juridiksion që paraqiten para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka kaluar çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore.

Duke parë në tërësinë e tij ecurinë e procedurës administrative, vendimin e gjykatës dhe gjykimin e deritanishëm të çështjes, pakica është e mendimit se çështja duhej zgjidhur ndryshe.

Nisur nga objekti i kërkesëpadisë, përmbajtjes së saj, si dhe nga kërkimet e paraqitura nga palët gjatë gjyimit, pakica vlerëson se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me konkluzionin e arritur dhe zgjidhjen e dhënë, nuk kanë respektuar kërkesat e neneve 15-18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, si dhe të neneve 6 e 13 të KEDNJ.

Në kuptim të ligjit për kthimin e kompensimin e pronës, të dyja palët ndërgjyqëse janë subjekte që legjitimohen të kërkojnë pranë zyrave rajonale të KK Pronave njohjen dhe kthimin apo kompensimin e pronës për rastet e parashikuara në nenin 2 të ligjit të sipërcituar.

Më pas, për çdo pretendim në lidhje me vendimet e zyrave rajonale mund të ankimohen pranë AKKP Tiranë, e cila ka të drejtë të shprehet në një nga tri format e njohura nga neni 18 i ligjit nr.9235, datë 29.07.2004.

Sipas nenit 18 të ligjit për kthimin e kompensimin e pronës mund të ushtrojë ankim në AKKP Tiranë vetëm subjekti konkret në emër të të cilit ka dalë vendimi i zyrës rajonale dhe jo ndonjë subjekt tjetër, pavarësisht nga pretendimi i tij.

Kjo dispozitë, në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se asnjë subjekt, jashtë pjesëmarrësve në procesin administrativ, nuk mund të godasë vendimin e zyrave rajonale në AKKP, veç subjektit kërkuar. Ç'ka do të thotë se secili subjekt ka të drejtë të kundërshtojë vetëm vendimin e zyrës rajonale, e cila është shprehur për kërkesën e tij. Ai nuk mund të godasë vendimet e dhëna nga kjo zyrë, apo vendimet e dhëna nga komisionet e mëparshme në favor të subjekteve të tjera.

Për rastin në shqyrtim, pala paditëse ka paraqitur kërkesë pranë organeve kompetente shtetërore, të cilat, me arsyetimin se sendi është disponuar më parë në favor të të tretëve, i kanë kthyer përgjigje negative (rrethana këto që në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara anashkalohen).

Bazuar në këtë ecuri dhe përgjigjen e organeve shtetërore përkatëse, paditësit i janë drejtuar gjykatës.

Gjithashtu, sipas nenit 18 të ligjit të mësipërm, vendimet e komisioneve të mëparshme apo dhe vendimet e zyrave rajonale, që nuk i përkasin subjektit të ankimit, mund të shqyrtohen vetëm me nismën e drejtorit të AKKP-së.

Nisma e drejtorit të AKKP-së është një e drejtë, por jo detyrim, për subjektin e shpronësuar. Ajo nuk është procedurë e detyrueshme administrative për subjektin e shpronësuar.

Pakica, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 6 e 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 18 të ligjit për kthimin e kompensimin e pronës, si dhe të rrethanave të faktit, vlerëson se ankimi administrativ i subjektit vetëm për të pasur/siguruar një akt formal negativ të së drejtës së tij të pretenduar nuk përbën “mjet ligjor efektiv”, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ.

E drejta për ankim efektiv është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton të drejtën e individit për ankim, ekzistencën e një organi të caktuar për shqyrtimin e ankimit, pranimin e pakushtëzuar të ankimit për shqyrtim, afate të arsyeshme për shqyrtimin e tij, një shqyrtim objektiv, kontroll gjyqësor, si kontroll përfundimtar ndaj ankimit, si dhe mundësinë e rehabilitimit të mundshëm si pasojë e pranimit eventual të ankimit.

Gjykata, në rastet kur shtrohet çështja e ezaurimit të mjeteve administrative, para së gjithash verifikon/kontrollon nëse në rastin konkret ka mjete ankimi administrativ dhe nëse evidentohet se ato ekzistojnë, verifikon efektivitetin e tyre, p.sh. a njihet ose mohohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), ose a paraqiten të tilla këto mjete saqë, sipas jurisprudencës së vazhdueshme të gjykatave, mund të konsiderohet e kotë të pritët një vendim që mund të vinte në vend të drejtën e shkelur etj. Në këtë kontekst ka rëndësi që legjislacioni i zbatueshëm të parashikojë jo vetëm të drejtën e ankimit, por dhe sigurinë/mundësinë autoritetit shtetëror që do të mund të marrë vendimin respektiv përfundimtar, sepse e drejta e ankimit efektiv nënkupton jo vetëm mundësinë e shqyrtimit të çështjes, por dhe zgjidhjen e saj përfundimtare.

E rëndësishme është që ky autoritet administrativ të jetë në përputhje me kërkesën e efektivitetit të ankimit, garantuar nga neni 13 të KEDNJ, sidomos përsa i përket fuqisë detyruese të vendimit që merr. Nga ky këndvështrim, duhet theksuar se mjetet e ankimit duhet të jenë efektive në aspektin ligjor e praktik dhe se vendimi që merret nga organi përkatës duhet të prekë themelin e çështjes, apo të së drejtës së pretenduar dhe jo vetëm formën e tij.

Për rastin konkret, ndodhur në rrethanat e ligjit e të faktit, kur subjekti (kërkuar) nuk mund të ankimojë vendimin e personit i cili ka tërhequr të drejta pronësie mbi sendin e pretenduar edhe prej tij, subjekti jo detyrimisht duhet të ndjekë rrugën administrative, pasi sigurimi i një vendimi, qoftë edhe negativ, nuk plotëson kërkesat e një mjeti ligjor efekti e bie ndesh me përmbajtjen e nenit 13 të KEDNJ.

Pra, kërkesa për kthim të pronës, kur dihet përgjigja negative e organit shtetëror, është mjet jo efektiv dhe për pasojë mosushtrimi i tij nuk mund të pengojë përdorimin e padisë si mjet efektiv.

E drejta për të ushtruar një mjet ligjor efektiv nuk mund të pengohet nga mosushtrimi i një mjeti jo efektiv.

Pakica, duke vlerësuar se interpretimi i nenit 18 të ligjit të sipërcituar bëhet kundrejt një çështje konkrete e për të prodhuar një rezultat të caktuar, që rrjedhon me pasoja edhe për çështje të tjera të kësaj natyre, e konsideron ankimin administrativ një mjet jo efektiv. Në këtë kuptim, konkluzionet e arritura nga Kolegjet e Bashkuara nuk mund të shërbejnë apo të kenë efekte pozitive për njësim të praktikës gjyqësore, sepse, veç kohëzgjatjes dhe sigurimit të një vendimi negativ (formal) nga procedura

administrative, ankimi dhe pretendimet e subjektit ankues nuk do të shqyrtohen në themel dhe autoriteti shtetëror nuk do të marrë vendim përfundimtar në realizimin e “reabilitimit” të mundshëm si pasojë e pranimit eventual të ankimit.

Në argumentim sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë jemi të mendimit se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe për këtë shkak ai duhet të prishej dhe çështja t’i kthehej për vazhdimin e gjykimit po asaj gjykate.

Anëtarë: Spiro Spiro, Evjeni Sinoimeri, Perikli Zaharia, Ardian Nuni, Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj

UDHËZIM
Nr.16, datë 8.5.2009

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR SHPËRNDARJEN DHE RISHPËRNDARJEN E FONDVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për mënyrën e shpërndarjes së fondeve publike subjekteve zgjedhore, që do të marrin pjesë në zgjedhje për Kuvendin, 2009 dhe për mënyrën e rishpërndarjes së fondeve publike subjekteve zgjedhore që do të përfitojnë mandate.

Neni 2

KQZ-ja me vendim cakton sasinë e fondeve që do të marrë secila prej partive politike, që plotëson kushtet e përcaktuara në germen “a” të pikës 2 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor (të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor, të ketë mandate në Kuvend dhe të ketë regjistruar listat shumëmemërore për zgjedhjet për Kuvendin 2009), sipas rregullave më poshtë:

a) 50 për qind e fondit publik të vënë në dispozicion për subjektet zgjedhore pjesëtohet me shumën e mandateve të fituara në zgjedhjet pararendëse nga partitë politike të përcaktuara në këtë nen, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve 2005.

b) Çdo partie politike, të përcaktuar në këtë nen, i jepet ajo sasi nga fondet publike, që del nga shumëzimi i numrit të mandateve që ka marrë në zgjedhjet pararendëse me numrin e dalë nga pjesëtimi sipas germës “a” të këtij neni.

Neni 3

KQZ-ja me vendim cakton sasinë e fondeve që do të marrë secila prej partive politike që plotëson kushtet e përcaktuara në germen “b” të pikës 2 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor (të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor dhe të ketë marrë jo më pak se 2 mandate në Kuvend) sipas rregullave më poshtë:

a) 50 përqind e fondit publik të vënë në dispozicion për subjektet zgjedhore pjesëtohet me shumën e votave të fituara në zgjedhjet pararendëse në shkallë kombëtare nga partitë politike të përcaktuara në këtë nen, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve 2005.

b) Çdo partie politike, të përcaktuar në këtë nen, i jepet ajo sasi nga fondet publike që del nga shumëzimi i numrit të votave të marra në shkallë kombëtare prej saj, në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin, 2005, me numrin e dalë nga pjesëtimi sipas germës “a” të këtij neni.

Neni 4

Në rast se, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Kuvendin, 2009, nga KQZ, rezultojnë se partitë politike të cilat kanë përfutur fonde sipas nenit 3 të këtij udhëzimi dhe nuk kanë marrë

asnjë mandat në zgjedhjet për Kuvendin, 2009, duhet të kthejnë shumën përkatëse të përfutur, sipas rregullave të përcaktuar në pikën 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor.

Neni 5

KQZ-ja me vendim do t'u rishpërndajë partive politike, të cilat do të përfitojnë mandate në Kuvend, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin, 2009, shumën e fondeve të kthyer sipas nenit 4 të këtij udhëzimi, duke u bazuar në rregullat më poshtë:

a) Shuma e fondeve të kthyer nga subjektet zgjedhore sipas nenit 4 të këtij udhëzimi, pjesëtohet me shumën e mandateve të fituara në Kuvend në zgjedhjet e radhës nga partitë politike, e përcaktuar kjo, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin, 2009.

b) Çdo partie politike që përfiton fonde publike sipas këtij neni, i jepet ajo sasi nga fondi publik që del nga shumëzimi i numrit të mandateve të fituara prej saj në Kuvend me numrin e dalë nga pjesëtimi, sipas gurmës “a” të këtij neni.

Neni 6

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Arben Ristani

UDHËZIM

Nr.17, datë 22.5.2009

PËR MBLEDHJEN, ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT PËR PROCESIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT TË SHQIPËRISË, 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 119, pika 2 dhe nenit 122, pika 3 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat që do të zbatojnë KZAZ-ja dhe KQZ-ja për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për procesin e numërimit të votave për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, 2009.

Neni 2

Informacioni që do të japë KZAZ-ja

Pas mbylljes së votimit, KZAZ-ja duhet të dërgojë në KQZ informacionin për:

a) Rregullsinë e kutive të fletëve të votimit dhe kutive me materialet e votimit të marra në dorëzim nga KQV-të;

b) Rezultatet e zgjedhjeve të çdo QV-je për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit në mënyrën e përcaktuar në këtë udhëzim.

c) Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor përkatës.

Neni 3

Përmbajtja e informacionit për rezultatet e zgjedhjeve

1. Informacioni për procesin e numërimit të votave mbështetet në tabelat e rezultateve të plotësuar nga grupet e numërimit dhe të dorëzuara në KZAZ.
2. Informacioni duhet të përmbajë domosdoshmërisht për çdo QV:
 - a) Numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
 - b) Numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
 - c) Numrin e fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit;
 - d) Numrin e votave të pavlefshme;
 - e) Numrin e votave të vlefshme;
 - f) Shpërndarjen e votave të vlefshme për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Neni 4

Përgjegjësia për përcjelljen e informacionit në KQZ

Përcjellja e informacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, në KQZ, bëhet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e sekretarit të KZAZ-së.

Neni 5

Mënyra e dhënies së informacionit për rezultatet nga KZAZ-ja në KQZ

1. KZAZ-ja përcjell në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën “a” të nenit 2 të këtij udhëzimi, menjëherë pas marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja të kutive të fletëve të votimit dhe kutive me materialet e votimit nga të gjitha KQV-të.
2. KZAZ-ja përcjell në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën “b” të nenit 2 të këtij udhëzimi, menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GN-ja. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GN-ve sipas kësaj mënyre:
 - a) Sekretari i KZAZ-së, pasi GN-ja i dorëzon tabelën e rezultateve të një QV-je, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave. Operatori i hedh të dhënat e tabelës së rezultateve në aplikimin elektronik në kompjuter dhe printon në letër informacionin që ka në formë elektronike. Në momentin e printimit aplikimi elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/i pa shkrueshëm.
 - b) Tabela e printuar nga forma elektronike i dorëzohet GN-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar vërtetësinë e të dhënave.
 - b.1 Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet drejt KQZ.
 - b.2 Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GN-së bën korrigjimet me shkrim dore në fletën e printuar dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GN-së. Sekretari i KZAZ-së kthen aplikimin elektronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korrigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe dërgimit në KQZ.
3. Format i printuar dhe tabela origjinale e rezultateve i bashkëngjiten njëra-tjetrës dhe shërbejnë si dokumentacion zyrtar që i dorëzohet KQZ-së.
4. Pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve dhe miratimit nga KZAZ-ja i tabelës përmbledhëse të rezultateve për ZAZ-në përkatëse, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, konfirmimin e miratimit.

Neni 6

Publikimi i informacionit lidhur me procesin e numërimit të votave

Me marrjen e informacionit nga KZAZ-të, KQZ-ja bën publikimin në dinamikë të rezultateve në rang zone zgjedhore/qarku.

Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në monitorët e sallës së mediaeve, në faqen e KQZ-së në internet dhe printohet në letër.

Informacioni do të jepet në numër votash të vlefshme të fituara dhe përqindje përkatëse për koalicionet, partitë dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Neni 7

Informacioni i publikuar nga KQZ-ja, në çdo rast, shoqërohet me numrin gjithsej të QV-ve në zonën përkatëse zgjedhore dhe me numrin e QV-ve mbi të cilin është llogaritur rezultati i dhënë.

Neni 8

Informacioni i publikuar sipas këtij udhëzimi nuk përbën rezultat zyrtar.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ristani

VENDIM
Nr.34, datë 7.5.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “WONDER POWER” SHA NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 5 pika 2, germa “g” dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.5.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Wonder Power” sh.a., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se :

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Wonder Power” sh.a., ka nisur me marrjen e vendimit nr.14, datë 6.3.2009.

- Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Wonder Power” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me një kohëzgjatje të vlefshmërisë së licencës deri në datën 18.12 .2033.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.35, datë 7.5.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EFT ALBANIA”
SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 45 pikat 3, 4, dhe 8 pika 2 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.5.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për license të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.36, datë 7.5.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EFT ALBANIA”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 13 pikat 1, germa “d”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.5.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të

licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipërcituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.31, datë 6.5.2009

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHETËTËRORE “PËR SHPALLJEN E ZONËS
EKONOMIKE ME STATUSIN E ZONËS SË LIRË, VLORE”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|---------|
| - z. Gend Ruli | Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | Anëtare |
| - znj. Mimoza Vokshi | Anëtare |
| - z. Viktor Gumi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 6.5.2009, shqyrtoi raportin “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për shpalljen e zonës ekonomike me statusin e zonës së lirë, Vlorë”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore nga Drejtoria e Zhvillimit të Parqeve Industriale dhe Zonave të Lira në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me shkresën nr.3747/2, datë 4.5.2009 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.A1/N/008/2009.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës është ligji nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.860, datë 10.10.2007 “Për miratimin e rregullores së krijimit dhe të funksionimit të zonave ekonomike”, si dhe vendimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.20, datë 1.11.2007 “Për skemën ekzistuese, ligjin nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, amenduar me ligjin nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.

Objekti/vat: Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv kryesor zhvillimin rajonal, i cili synohet të arrihet përmes kryerjes së investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, të lidhura me këto investime.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Projekti për zhvillimin e zonës konsiderohet si një projekt me interes të rëndësishëm për vendin. Ai parashikohet të sjellë zhvillim të rajonit, nëpërmjet investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

2. Zona parashikohet të jepet me koncesion, në formën BOT (ndërtim, operim dhe transferim) dhe procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës do të kryhet në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

3. Periudha e funksionimit të zonës propozohet të jetë deri në 35 vjet.

4. Dhënia e terminalit të kontejnerëve me koncesion, i cili do të operojë paralelisht me zonën e lirë, parashikohet që të zhvillohet në bazë të një plani afatgjatë investimi, detajimi i të cilit pritet të shqyrtohet në një periudhë të mëvonshme.

5. Në zonën e lirë përcaktohet të zhvillohen veprimtari portuale, industriale dhe përpunimi; veprimtari tregtare dhe të shërbimeve, magazinim i mallrave. Përfshihet zhvillimi në zonë i veprimtarive që lidhen me prodhimin e çelikut.

6. Përfituesit e ndihmës kanë një përparësi ekonomike në formën e përjashtimit nga TVSH-ja dhe detyrimet doganore, e cila është ndihmë operationale. Përfituesit e ndihmës janë zhvilluesi i zonës, përdoruesit dhe operatorët që do të ushtrojnë veprimtarinë në këtë zonë. Në rastin e zhvilluesit të zonës, parashikohet edhe një element tjetër ndihme në formën e përdorimit të pronës shtetërore në një çmim poshtë atij të tregut, sipas kushteve që pritet të parashikohen në kontratën e formës BOT.

PËR KËTË ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 13 pika 2, nenit 14 pika 1, nenit 17, shkronja “ç”, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe të nenit 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin për shpalljen e zonës ekonomike, me statusin e zonës së lirë, në Vlorë,
2. Nga ky plan ndihme do të përfitojnë të gjitha ndërmarrjet që do të ushtrojnë veprimtaritë sipas pikës 3 të projektvendimit të Këshillit të Ministrave.

3. Nga plani, në asnjë rast, nuk mund të përfitojnë ndërmarrjet në vështirësi dhe, si të tilla, ato nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zonë.

4. Kontributi i përfituesit/përfituesve për financimin e investimit fillestar duhet të jetë të paktën 25%.

5. Në çdo rast ndihma përfituese do të jetë e lejueshme nëse lidhet me një projektinvestimi fillestar dhe krijimin e vendeve të reja të punës, në bazë të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”.

6. Intensiteti i ndihmës për ndërmarrjet e mëdha nuk duhet të kalojë 50%. Ky kufi mund të rritet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të vendosura në zonë, me 15% të vlerës bruto. Përveç kostove të pranueshme, të lidhura me investimin dhe të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, në llogaritjen e intensitetit do të merren parasysh të gjitha përjashtimet apo lehtësimet nga taksat, si dhe të gjitha format e tjera të ndihmës. Nuk lejohet përshtimi i ndihmës që tejkalon maksimumin e lejuar të intensitetit, për të njëjtat kosto të pranueshme.

7. Çdo ndryshim i mundshëm i planit të ndihmës, të njoftohet pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore në fuqi.

8. Drejtoria e Zonave të Lira dhe Parqeve Industriale, brenda datës 31 mars të çdo viti, të raportojë pranë DNSH për impaktin e investimeve dhe realizimin e të gjithë treguesve të tjerë gjatë vitit paraardhës financiar, të parashikuara në licencat përkatëse për ndërmarrjet që përfitojnë në kuadër të ndihmës individuale nga dispozitat e ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, si dhe të japë çdo informacion që do të kërkohet nga DNSH-ja, për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

9. Ky plan ndihme do të zbatohet në përputhje me detyrimet që do të vijnë si pasojë e procesit të integritetit të Shqipërisë në BE.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Genc Ruli**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 8.6.2009
Doli nga shtypi më 8.6.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë